

Shkëmbim idesh mbi fushat potenciale të bashkëpunimit mes KMSHC-së dhe OECD/SIGMA

Në vijim të diskutimeve me përfaqësuesin e SIGMA për Shqipërinë, Timo Ligi, për prioritetet e punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u zhvillua edhe një tjetër takim online mes Komisionerit dhe përfaqësuesve të OECD/ SIGMA, për konkretizimin e fushave të bashkëpunimit.



Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Lefterije Lleshi, (Luzi), gjatë këtij takimi online, ku mori pjesë edhe përfaqësuesi i OECD, z. Lech Marcinkowski, prezantoi objektin e veprimtarisë së institucionit dhe u ndal edhe në fushat potenciale të bashkëpunimit, që lidhen me konsultimin e indikatorëve institucionalë dhe përmirësimin e raporteve vjetore mbi veprimtarinë mbikëqyrëse të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Programi SIGMA është një iniciativë e përbashkët e OECD-së dhe Bashkimit Evropian, që mbështet forcimin e kapaciteteve administrative dhe modernizimin e shërbimit civil në vendet partnere.

